

KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT KORÇË

V E N D I M

Nr. 12 datë 10.05.2007

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE FAMILJEVE TË DËMTUARA SI REZULTAT I DJEGJES SË BANESËS

Keshilli i Bashkise se qytetit te Korces ne mbledhjen e tij te dates se sotme, pasi mori ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Sekt. Sportit dhe Emergj. Civile, Drejtoria e Finances dhe Drejtoria Juridike, " Per dhenien e ndihmes financiare familjeve te demtuara si rezultat i djegjes se baneses", bazuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 206 date 26.03.1998, i ndryshuar, " Per kriteret per pjesemarjen e shtetit per perballimin e demeve ne raste fatkeqesish", Ligjin Nr 8652 date 31.07.2000, "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32, germa dh. Ligjit nr. 8399 date 09.09.1998 "Per buxhetin lokal" neni 6, Udhhezimi nr. 2, date 17.01.2007, i Ministrise se Financave, " Per zbatimin e buxhetit te shtetit per vitin 2007", V.K.Bashkise nr. 2, date 02.02.2007, "Per miratimin e buxhetit te Bashkise dhe institucioneve te vartesise per vitin 2007", dhe pas diskutimeve te keshilltareve:

V E N D O S I

1. Te ndihmohen familjet Mani te cilet u demtuan nga djegja e baneses se tyre e ndodhur ne lagjen nr. 1, rruga " Konferenca e Labinotit" nr. 2, ku figurojne kater familje, te konfirmuara nga Zyra e gjendjes Civile, Masa e ndihmes per demin **ne paisje e orendi** do te jete si me poshte:

Familja Kristaq Mani e perbere nga 3 persona. $3 \times 20000 = 60000$ lek.

• Familja Gago Mani e perbere nga 2 persona $2 \times 20000 = 40000$ lek.

• Familja Sotirag Mani i vetem. $1 \times 20000 = 20000$ lek.

• Familja Vasi Mani i vetem. $1 \times 20000 = 20000$ lek

SHUMA 140000 LEK

2. Dokumentacini i plote, per ndihmen e familjeve nga demt i shkaktuar ne **anën ndertimore**, te dergohet ne Keshillin e Qarkut per ti percjelle per shqyrtim Ministrise se Brendeshme.(Depa. te Plan. e Perba. Emergj. Civile)

3. Te ndihmohet familja e z. Ilir Paravani i cili u demtua nga djegja e orendive shtepiake, me shumen prej **30.000 lek.**(tridhjetmije).

4. Ky fond do te perballohet nga fondi rezerve i te ardhurave te Bashkise me kete strukture:

Pakesohet	00	04980	05	Art. 6091100	- 170.000
Shtohet	00	01110	05	Art. 6061041	+ 170.000

5. Per zbatimine ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Finances, Sek.Sporti dhe Emergjencave Civile e Drejtoria Juridike.

6. Ky vendim hyn ne fuqi me nje here.

K R Y E T A R I

Rajmonda NASE